



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI

Sesioni pranveror

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi

Mbledhja nr. 29

Prishtinë, më 4.7.2018, në orën 13:30

Ndërtesa e Kuvendit, salla N- 204

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Ismajl Kurteshi, kryetar, Teuta Haxhiu, Nezir Çoçaj, Driton Çausi, Arbërie Nagavci, Mufera Shinik, Fidan Rekalju, Valentina Bunjaku- Rexhepi dhe Albulena Balaj-Halimaj.

Munguan: Abdyl Salihu dhe Verica Çeraniq.

Përfaqësues të tjerë: Natalija Apostolova, udhëheqëse e Zyrës së BE-së dhe përfaqësues të mediave.

Stafi mbështetës i Komisionit: Lule Ymeri dhe Rudinë Fetahaj.

Ismajl Kurteshi, pasi i uroi mirëseardhje ambasadores Apostolova , falënderoi BE-në për interesimin e shfaqur për punën e Komisionit si dhe e njoftoi për detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit karshi arsimit në Kosovë. Si detyra të Komisionit, ai përmendi shqyrtimin e projektligjeve që mund të vijnë kryesisht nga Qeveria, por që mund edhe të iniciohen nga 10.000 qytetarë ose edhe me propozimin e ndonjë deputeti.

Kurteshi tha, se detyrë e Komisionit është edhe mbikëqyrja e punës së institucioneve të arsimit, monitorimi i implementimit të ligjeve në fuqi, vizita e institucioneve të arsimit dhe të gjitha institucioneve tjera që janë në linjë me punën e Komisionit si dhe shqyrtimi i raportit të agjencive ose këshillave të pavarur që lidhen me arsimin.

Ai i njoftoi të pranishmit që deri më tani janë proceduar 3 ligje, 2 nga të cilat kanë përfunduar me shqyrtim në Komision. Me këtë rast veçoi Ligjin për Inspektoratin e Arsimit, duke shpresuar që ky ligj do të ndikojë shumë në ngritjen e cilësisë së arsimit në Republikën e Kosovës, si njëra ndër sfidat më të mëdha që ka vendi.

Komisioni, shtoi Kurteshi, e ka filluar punën edhe për Projektligjin për mësimdhënësit e viteve të 90-ta si dhe që janë në proces të monitorimit të dy ligjeve; njëri për trashëgiminë kulturore dhe Ligjin për Sponsorizime dhe Donacione.

Komisioni ka realizuar vizita të ndryshme në Ministrinë e Arsimit, Ministrinë e Kulturës, Këshillin për Trashëgiminë Kulturore, si dhe shkolla dhe Universitetin e Prishtinës dhe gjatë kësaj periudhe janë organizuar dy tryeza, të cilat kanë pasur për qëllim trajtimin e çështjes së arsimit parashkollor dhe për fëmijët me aftësi të kufizuara.

Ai gjithashtu përmendi edhe organizimin e tryezës mbi prioritetet e Arsimit Parauniversitar si dhe Rezolutën e propozuar në Kuvend, me të cilën arsimit është prioritet kombëtarë, por që fatkeqësisht kjo Rezolutë ka mbetur vetëm një dokument që nuk është respektuar as me ndarjen e buxhetit në 2018, e as pikat tjera që obligojnë MASHT-in.

Në fund, Kurteshi tha, se Komisioni i është mirënjohës të gjitha organizatave ndërkombëtare që po e ndihmojnë arsimin, duke shtuar se arsimit në Kosovë do të ecë përpara me rritjen e investimeve, me një organizim më të mirë dhe një konsistencë në ngritjen e cilësisë së arsimit.

Natalija Apostolova, tha se Komisioni i Arsimit është shumë i rëndësishëm për Bashkimin Evropian si dhe është tejet e rëndësishme që të ketë një bashkëpunim të mirë në mes të BE-së dhe Komisionit, duke marrë parasysh faktin që Kosova është një shtet i ri me një popullatë mjaftë të re. Ajo tha, se reforma në edukim, jo vetëm që është e domosdoshme, por që çdo ditë që kjo reformë vonohet, paraqet një krim ndaj gjeneratës së re.

Apostollova tha se Zyra e BE-së ka identifikuar edukimin si një nga prioritetet kyçe në Kosovë duke investuar 6 milion euro në sektorin e edukimit për vitin 2016, shifër kjo e cila pritet të rritet deri në 15 milionë për vitin 2017/18, kurse në total BE-ja ka investuar në fushën e edukimit rreth 34 milionë euro, që sipas saj është shumë shqetësuese sepse gjendja e arsimit në Kosovë vazhdon të jetë e mjerë, bazuar në rezultatet e testit PISA dhe raportit që është përgatitur nga GIZ-i. Prandaj, shtoi ajo, të gjithë do të duhej të angazhohen në përmirësimin e edukimit, kurse rezultatet mund të shihen vetëm në terma afatmesëm ose afatgjatë.

Ajo tha se ndihet shumë e lumtur që në vitin 2017, të gjithë deputetët kanë vendosur edukimin si prioritet kombëtar dhe shpreson që kjo deklaratë të mos mbetet vetëm në letër. Marrë parasysh raportin e GIZ-it, ajo tha se reforma e cila duhet menjëherë të fillojë e që janë reforma të kushtueshme dhe të dhimbshme, janë reformat që duhet bërë në MASHT. Ajo tha se Zyra e BE-së ka kërkuar nga GIZ-i që të përgatisë një plan të veprimit përmes të cilit do të formatizohen reformat në këtë Ministri, përmes një organogrami të ri për ristrukturimin e Ministrisë.

Sipas saj, do të ketë rezistencë të fortë për këtë ristrukturim nga ana e Ministrisë, mirëpo, BE-ja nuk do të dorëzohet, pavarësisht kohës, parave dhe përpjekjeve. Ajo tha se në Ministri ka shumë drejtorë të cilët e kryejnë punën e njëjtë dhe marrin paga e që i kushton shumë Ministrisë, ndërsa me organogramin e ri, struktura do të bazohet në përvoja ndërkombëtare, menaxheri i lartë i kësaj ministrie duhet të ketë nivel të lartë të ekspertizës, të jetë i moralshëm dhe të marrë përsipër detyrat dhe përgjegjësitë. Organogrami i ri do të implementohet pas një muaji, pas disa konsultimeve me Ministrinë e Administratës Publike dhe miratimin e Qeverisë dhe shpreson që MASHT-i do të zbatojë këtë organogram dhe se pozitat do t'i fitojnë njerëzit me përvojë dhe të kualifikuar.

Në anën tjetër, Apostolova njoftoi deputetët që janë në përcjellje të Ligjit për Arsimin e Lartë, i cili pritet të vijë në Kuvend para shtatorit. BE-ja ka ofruar ekspertizë ligjore, në mënyrë që ligji të harmonizohet me *acquiscommunautaire* të praktikave evropiane.

BE-ja synon të sigurojë transparencë në promovimin akademik të rekrutimit të stafit, forcën dhe sigurimin e cilësisë së pavarësisë së Agjencisë së Akreditimit dhe rritjen e autonomisë dhe integritetit të arsimit të lartë. Ndryshimet që kanë ndodhur në pozitat udhëheqëse të Agjencisë, kanë ndikimin negativ në pranimin e kësaj Agjencie në regjistrin e sigurimit të cilësisë së BE-së, nga i cili ishte përjashtuar kohë më parë. Për të kthyer kredibilitetin e institucioneve, ajo tha se kishte këshilluar ministrinë që procesi i përzgjedhjes të jetë transparent.

Për fund, Apostollova tha se projektligji i cili është shumë shqetësues për ta, është ai për statusin e punëtorëve të viteve të 90- ta dhe se ky ligj duhet parë nga të gjitha perspektivat. Ajo tha se duke marrë parasysh që administrata e shërbimeve ligjore ka vendosur që të shkojë në grevë pasi kanë kërkuar rritje të rrogës për 100%, si dhe mundësinë që edhe organizatat tjera të kërkojnë pensionin e merituar për atë periudhë kohore, ky ligj do ti kushtojë shumë Buxhetit të Kosovës, andaj duhet pasur shumë kujdes.

Teuta Haxhiu, tha se pajtohet me qëndrimet e Apostolovës dhe që shpallja e arsimit prioritet do të duhej të ekzistonte jo vetëm në letër. Ajo tha se pa depolitizim e arsimit do të jetë e vështirë të arrihen rezultate pozitive në arsim. Sipas Haxhiutj, janë disa ligje që e pamundësojnë arritjen e rezultateve, duke përmendur të drejtën e kryetarëve të komunave për të zgjedhur drejtorët e shkollave. Ajo tha se pajtohet që MASHT-in dhe ka nevojë për një organogram të ri dhe do të ishte ideale, sikur kjo ministri të udhëhiqej nga dikush apolitik.

Muferra Sinik falënderoi përfaqësuesen e BE-së për përkrahjen për arsimin dhe tha se arsimi në gjuhën turke zhvillohet që nga shkolla fillore, e mesme dhe arsimit të lartë. Sa i përket ndihmës së BE-së në arsim, tha se, është mirë që të ndahen mjetet e projektet edhe për komunitetet kurse në shkollat e komunitetit turk, tha se mungojnë psikologët dhe pedagogët si dhe tekstet shkollore në disa prej shkollave të mesme turke, ndërsa sa i përket pensioneve, ceku se personat që janë të paaftë dhe të sëmurët do të duhej të kenë pension të parakohshëm.

Valentina Bunjaku-Rexhepi, tha se ky takim është i domosdoshëm sepse arsimit në Kosovë ka jashtëzakonisht mangësi të mëdha, marrë parasysh Raportin e progresit. Ajo shprehu mirënjohje për investimin monetar të BE-së në Kosovë, mirëpo, tha se vendi jonë ka nevojë shumë edhe për ekspertë të jashtëm të Arsimit që të ndihmojnë në procesin dhe reformat në arsim. Gjithashtu, tha, që jo vetëm MASHT-i ka nevojë për reforma, por edhe nivelet më të larta kanë nevojë për një reformë të tillë.

Sa i përket përgatitjes së studentëve për tregun e punës, ajo tha se atyre iu duhet një përkujdesje më e veçantë në shkollat profesionale dhe e ceku nevojën e pedagogëve, psikologëve dhe asistentëve specialë në shkollat e ndryshme në Kosovë, marrë parasysh praninë e fëmijëve me aftësi të kufizuara. Ajo tha, se Komisioni është i hapur të bashkëpunojë me secilin që për interes ka reformën në arsim dhe ngritjen e cilësisë.

Nezir Çoçaj, falënderoi të pranishmit për praninë e tyre dhe kontributin e dhënë për sektorin e arsimit në Kosovë që nga paslufta. Ai tha se duke qenë pjesë e MASHT-it, është i njoftuar me kontributin që ka dhënë BE-ja për cilësinë e arsimit në vendin tonë.

Çoçaj e ceku edukimin parashkollor si një nga problemet kyçe në sektorin e arsimit, përfshirjen shumë të vogël të fëmijëve në këtë fazë të edukimit si dhe mungesën e çerdheve publike në shumë vende të Kosovës dhe përgatitjen e stafit në edukimin parashkollor. Ai tha se investimi në këtë fazë të edukimit, ka ndikim të jashtëzakonshëm në zhvillimin e fëmijëve përgjatë gjithë jetës së tyre. Në anën tjetër, ai cilësoi shqetësuese edhe numrin e vogël të përfshirjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara në procesin arsimor dhe bëri thirrje që kjo kategori të privilegjohet më shumë. Gjithashtu, tha se përgatitja e mesimdhënësve dhe bazimi i tyre në kurrikula të vjetra, përben një problem shumë serioz që ndikon negativisht në cilësinë e arsimit. Ai tha, që sa më parë që ky ligji për arsimin në komuna të ndryshojë, aq më shumë do të ketë sukses edhe arsimit në Kosovë.

Arbërie Nagavci, tha se kontributi i BE-së në arsim nuk qëndron vetëm infrastrukturën e shkollave por edhe te reformat e mëdha që janë bërë, mirëpo, që fatkeqësisht nuk janë dhënë rezultatet e dëshiruara. Ajo kërkoi vëmendjen e BE-së që reformat apo hapat që i ndërmarrin, të zbatohen vërtetë dhe të insistojnë që këto reforma t’ju përmbahen kritereve të caktuara dhe të cilat do të mundësonin një përmirësim të cilësisë në këtë drejtim.

Nagavci tha se ministri i Arsimit publikisht e ka pranuar që arsimit nuk është prioritet i kësaj qeverisjeje dhe që politika dhe ndikimi i saj ka bërë që këto reforma të mos zbatohen, duke i bërë edhe partitë politike përgjegjëse për gjendjen aktuale të cilësisë së arsimit në Kosovë. Ajo mbështeti dhe përgëzoi reformën e organogramit në MASHT dhe që kriteret e përmendura për Ministrinë e Arsimit të kërkohen edhe për Inspektoratin e Arsimit, meqë edhe ata janë përgjegjës për cilësinë. Do të ishte mirë sikur këta inspektorë do të kalonin përmes një testimi shtetëror për të garantuar mbi kualifikimet dhe aftësitë e tyre profesionale. Në anën tjetër, Nagavci kërkoi mbështetjen e BE-së në monitorimin e ligjeve dhe implementimin e tyre.

Albulena Balaj, falënderoi përfaqësuesen e BE-së për praninë e saj. Ajo mbështeti qëndrimin e Apostolovës që sa më shumë vonesa të ketë në reforma, aq më i madh është krimi ndaj gjeneratës së re. Ajo tha se ka pasur përpjekje për reforma, mirëpo, për shkak të mosanalizimit të duhur, këto reforma kanë dështuar. Në anën tjetër, Balaj kërkoi nga përfaqësuesja e BE-së të sqarojë qëndrimin e saj rreth rezistencës së Ministrisë së Arsimit karshi organogramit të ri sepse sipas saj, ministri i Arsimit është i vendosur dhe i përkushtuar për ndryshime në arsim.

Sa i përket Ligjit për statusin e punëtorëve të viteve të 90-ta, ajo tha se anëtarët e Komisionit janë të vetëdijshëm mbi dëmin që do të shkaktohet buxhetit të Kosovës, mirëpo, janë të interesuar ta gjejnë një formulë, që nuk do të dëmtojë asnjërën palë.

Fidan Rekaliu, kërkoi nga përfaqësuesja e BE-së rritje të fondeve për organizatat rinore.

Natalija Apostolova, i falënderoi të gjithë deputetët për kontributin e tyre në këtë diskutim dhe i siguroi deputetët që ky takim nuk do të jetë i fundit që do të zhvillohet mes tyre. Ajo tha edukimi do të mbesë për një kohë të gjatë prioritet i BE-së si dhe se në të gjitha reformat që do të ndodhin. Ajo tha se ministri i Arsimit është shumë i përkushtuar, mirëpo, që ai vetë nuk mund ti bëjë të gjitha reformat, atij i duhet staf dhe administratë që do ta mbështesin në këtë rrugëtim. Apostolova tha, se paratë nuk mund të bëjnë të gjithë ndryshimin që nevojitet, dhe se ndryshimi duhet të ndodhë në psikologjinë e shoqërisë sepse të gjithë të punësuarit duhet ta respektojnë orarin e punës.

Ismajl Kurteshi, falënderoi shumë ambasadoren dhe shprehu mirënjohjen e tij për kontributin e BE-së për ngritjen e cilësisë së arsimit, duke thënë se Komisioni është i hapur për çdo bashkëpunim potencial që mund të ndikojë në përmirësimin e kësaj gjendje, marrë parasysh faktin që barra bie në Komisionin për Arsim. Ai tha se paratë që i ka ndarë BE-ja, janë shumë, mirëpo, që ato nuk kanë pasur efektin e pritur, pasi që nuk janë monitoruar për implementimin e tyre. Ai mbështeti qëndrimin e ambasadores për reformat në arsim, mirëpo, tha që do të duhej të studiohen mirë, se cila reformë do të kishte rezultatin më të mirë të mundshëm. Ligji për arsimin e lartë është shumë i nevojshëm për arsimin në Kosovë, mirëpo, ai është penguar nga autoritetet e arsimit në gjuhën serbe, tha Kurteshi.

Sa i përket pavarësisë së Agjencisë të Akreditimit, Ismajl Kurteshi tha, se Komisioni është i interesuar që kjo Agjenci ta kryejë punën e saj, në mënyrë profesionale. Kurse për Projektligjin e viteve të 90-ta, tha se ky Projektligj e ka marrë përkrahjen e Komisionit dhe pas leximit të parë, janë organizuar dy dëgjime publike. Komisioni ka kërkuar komente me shkrim nga institucionet e përfshira, dhe që është në interes të Komisionit të mos e ngarkojë Buxhetin e Kosovës me këtë projektligj. Për fund, ai tha se ndryshimet duhet të ndodhin, jo vetëm në MASHT, por edhe në shkolla e institucione tjera arsimore, në mënyrë që të evitohet politizimi i tyre.

Mbledhja përfundoi në orën 14:30.

E përgatiti:
Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetari i Komisionit,
Ismajl Kurteshi